



VENDIM
Nr. 18, datë 10.3.2016

**PËR MIRATIMIN E FINANCIMIT PËR
VITIN 2016, PËR DISA PROJEKTE NË
VAZHDIM, TË GRANTIT “ARTI DHE
KULTURA”, PROGRAMI I ZHVILLIMIT
TË INFRASTRUKTURËS VENDORE DHE
RAJONALE, SHTYLLA I**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15, të aneksit 3, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Miratimin e financimit për vitin 2016, për disa projekte në vazhdim me cikël financimi 2015–2016, për grantin “Arti dhe kultura”, Programi i Zhvillimit Vendor dhe Rajonal, shtylla I, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministri i Kulturës dhe ministri i Financave, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYETARI
Niko Peleshi

Zëvendëskryeministri	Zëvendëskryetar
Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Mjedisit	anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë / Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore / Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4	anëtar.

Tabela 1. Lista e projekteve me cikël financimi 2015-2016, për financim përmes grantit Art-Kulturë, programi i zhvillimit vendor dhe rajonal, shtylla I, financimi për vitin 2016.

Nr.	Autoriteti Kontraktues	Emërtimi i projektit	Vlera e Projektit (në Lekë)	Vlera e Kontratës (në Lekë)	Vlera e realizuar në vitin 2015 (në Lekë)	Vlera e financimit për vitin 2016 (Lekë)
1	Bashkia Korçe	Qendra për Mbrojtjen dhe Promovimin e Kultures	60,000,000	49,302,893	49,302,893	0
2	Bashkia Korçe	Rikonstruksioni i Teatrit “A.Z. Cajupi”	59,987,330	59,987,330	7,000,000	52,987,330
3	Bashkia Shkoder	Rikonstruksioni Godines se Teatrit “Migjeni”	85,637,068	57,076,966	11,279,807	40,000,000
Totali			205,624,398	166,367,189	67,582,700	92,987,330

Shënim:

- "Vlera e projektit" përfaqëson vlerën e projektit të miratuar me Vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.
- "Vlera e kontratës" përfaqëson vlerën e kontraktuar nga autoriteti kontraktues për zbatimin e punimeve të projektit, dhe korrekton vlerën e projektit. Vlera e kontratës përcillet nga sekretariati teknik (Ministria e Kulturës).
- "Vlera e realizuar për vitin 2015" tregon vlerën e alokuar për vitin 2015, deri në 31.12.2015. Vlera e realizuar përcillet nga sekretariati teknik (Ministria e Kulturës).
- "Vlera e financimit", për vitin 2016, tregon vlerën e mbetur të financimit, pas diferencës midis vlerës së kontratës dhe vlerës së realizuar për vitin 2015.